



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:188652
Datë: 27.06.2024
Numri i dokumentit: 05876509

CA.nr.1210/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci-kryetar i kolegjit, Burim Shala, dhe Besnik Feka, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Xh.P. nga Mitrovica, rruga "...", numër ..., kundër të paditurës "A.G." SHPK, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti pagesa e pagave dhe kontributit pensional, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.5759/20, të datës 21.08.2023, në seancë e kolegjit të mbajtur me datë 27.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e paditësit Xh.P. nga Mitrovica, rruga "...", numër ..., **ANULOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.5759/20, i datës 21.08.2023, dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar C.nr.5759/20, të datës 21.08.2023, ka vendosur që të **KONSIDEROHET E TËRHEQUR** padia me numër C.nr.5759/20, e datës 30.12.2020, e paditësit Xh.P. nga Mitrovica, kundër të paditurës kundër të paditurës "A.G." SHPK, me seli në Prishtinë, me bazë juridike pagesë e të ardhurave personale.

Kundër këtij aktvendimi paditësi, në afatin e paraparë ligjor ka ushtruar ankesë dhe atë për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën, dhe aktvendimi i atakuar të priset dhe të obligohet gjykata e shkallës së parë që ta bëjë shqyrtimin e padisë.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e paditësit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton së paditësi, me datë 30.12.2020, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ka paraqitur padi kundër të paditurës për kompensimin e pagave të papaguara, dhe pagesën e trustit pensional, duke i propozuar gjykatës që të detyrohet e paditura, që paditësit t'ia kompensoj katër paga për periudhën nga data 01.09.2020 deri më 31.12.2020, me kamatë ligjore prej 8%, që nga ushtrimi i padisë e deri në pagesën definitive, si dhe t'ia kompensoj trustin pensional për periudhën e njëjtë.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seancës, ka marrë aktvendimin e atakuar C.nr.5759/20, të datës 21.08.2023, me të cilin e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit.

Në arsyetim të aktvendimi të atakuar gjykata ka konstatuar së pas shqyrtimit paraprak të padisë ka gjetur së nuk ka prova se pala paditëse ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për padi, andaj bazuar në dispozitën e nenit 253, paragrafi 4, të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr.03/L-006, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118 (LPK), paditësit i ka dërguar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për padi. Gjykata, bazuar në provat material që gjenden në shkresat e lëndës në dërgesën për dorëzim personal, konstaton se vërejtjen për pagesë të taksës gjyqësore për padi, me datën 20.07.2023, paditësi e ka pranuar personalisht, por i njëjti nuk ka bërë pagesën e taksës gjyqësore brenda afatit të përcaktuar. Tutje gjykata ka konstatuar se pala paditëse nuk ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për padi, dhe në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë kërkesë për lirim nga taksa gjyqësore për padi dhe nga provat e bashkangjitura padisë nuk rezulton se i njëjti plotëson kushtet ligjore për lirim nga taksa gjyqësore. Andaj, Gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 253, paragrafi 5, të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë, rreth mënyrës së vendosjes, nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga 182 par.1, lidhur me nenin 253 par.5 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga 182 par.1 të LPK-së, pasi që gjykata e shkallës së parë e ka zbatuar në mënyrë jo të drejtë dispozitën e neni 253 par.5 të LPK-së, sipas së cilës është paraparë së “Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga Gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr”, dhe kjo ka pasur ndikim në nxjerrjen e vendimit të ligjshëm dhe të drejtë. Kjo për faktin së gjykata e shkallës së parë e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit edhe pse në bazë të urdhërpagesës-dëftesës së pagesës të cilën paditësi ia ka bashkangjitur ankesës rezulton së paditësi e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për padi brenda afatit të caktuar nga gjykata.

Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë përmes vërejtjes C.nr.5759/20, të datës 10.02.2021, e ka ftuar paditësin që në afat prej 15 ditëve të bëjë pagesën e taksës gjyqësore për padinë e paraqitur kundër të paditurës, në shumën prej 20.00 euro, duke e paralajmëruar të njëjtin së nëse pagesa e taksës nuk bëhet në afatin e lartcekur, do të ndërmerren veprime konform nenit

5 par.5, pika 1 dhe 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017, të datës 22.03.2017, për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, si dhe nenit 253 par.5 të LPK-së. Në bazë të fletëkthesës për dorëzim personal rezulton së paditësi vërejtjen për pagesën e taksës e ka pranuar me datë 20.07.2023, ndërsa i njëjti pagesën e taksës gjyqësore e ka bërë me datë 25.07.2023, i cili fakt vërtetohet nga urdhërpagesa e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, dhe fletëtransferi i datës 25.07.2023. Nga kjo rezulton së nuk qëndron konstatimi i gjykatës së shkallës së parë së paditësi nuk e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për padi, sepse i njëjti pagesën e taksës gjyqësore për padi e ka bërë pas pesë ditëve pas pranimit të vërejtjes e që është brenda afatit të caktuar nga gjykata e shkallës së parë. Andaj, në kuptim të rrethanave të konstatuara dhe dispozitave të sipërcituara kjo gjykatë vlerëson se vendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të tilla për shkak të cilave aktvendimi i atakuar është dashur që të anulohet dhe çështja t'i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

Në riprocedurë, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që pas shqyrtimit paraprak të padisë dhe vlerësimit nëse padia i përmban të gjitha elementet siç është paraparë me nenin 253 të LPK-së, të vazhdoj me shqyrtimin e padisë së paditësit ashtu siç përcaktohet me dispozitat e LPK-së.

Nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.1210/2024, datë 27.06.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari
Hysni Bardheci